

10.5 BASHKËRENDIMI I REGJISTRIMEVE BIBLIOGRAFIKE ME ATO TË NJËSUARA

Pas shënimit të numrit identifikues të regjistrimit të njësuar SGC në nënfushën 60X3, në fushën për emërtimin lëndor transferohet pikëqasja e njësuar nga regjistrimi i njësuar SGC.



Shënim:

Nga regjistrimi i njësuar SGC në regjistrimin bibliografik nuk transferohen variantet e pikëqasjes, pikëqasjet në lidhshmëri dhe pikëqasjet e njësuara në gjuhë tjetër.

Pas çdo ruajtje të regjistrimit bibliografik, të dhënat bashkërendohen në mënyrë automatike me gjendjen aktuale në bazën e njësuar SGC.

Çdo ditë gjatë natës ekzekutohet në mënyrë automatike edhe bashkërendimi paketë i regjistrimeve bibliografike në COBIB.

Programi ngjashëm kujdeset për bashkërendimin (sinkronizimin) e regjistrimeve bibliografike me ato të njësuara edhe në bazat lokale të të dhënave. Se sa shpesh programi do të ekzekutoj bashkërendimin varet nga marrëveshja me bibliotekën.

Për bashkërendimin e regjistrimeve bibliografike me ato të njësuara, programi fillimisht gjen regjistrimet e njësuara, të cilat janë ndryshuar ose verifikuar nga data e fundit e bashkërendimit deri në datën aktuale. Më pas programi gjen të gjitha regjistrimet bibliografike, të cilat në nënfushën 3 përmbajnë numrat identifikues të këtyre regjistrimeve. Të gjitha fushat e këtyre regjistrimeve bibliografike, të cilat përmbajnë nënfushën 3, bashkërendohen me regjistrimet përkatëse të njësuara.

Ekzekutohet procedura në vazhdim:

- Nëse nënfusha 001a – *Statusi i regjistrimit* në regjistrimin e njësuar përmban kodin "d" – *regjistrim i fshirë*, programi gjen nënfushën 001x – *Numri i regjistrimit zëvendësues*. Këtu është i shënuar numri identifikues i regjistrimit të njësuar, i cili do të zëvendësoj regjistrimin e përzgjedhur për t'u fshirë. Më pas ky numër identifikues transferohet në nënfushën 3 në regjistrimin bibliografik, ndërsa përmbajtja e mëparshme e nënfushës 3 transferohet në nënfushën 9 – *Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*.
- Më pas në çdo fushë, në të cilën është i përfshirë kontrolli i njësuar, emërtimi lëndor zëvendësohet me pikëqasjen e njësuar nga regjistrimi përkatës i njësuar, numri identifikues i të cilit ndodhet në nënfushën 3.